

**AKT-THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**Protonclub**

NENI 1  
FORMIMI

**Sot me date 12.12.2024** themeluesi qe firmos me poshte:

- **Shoqeria “Proton”** Sh.p.k, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me seli ne adresen Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shkalla A, Kati 10, regjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Tirane me NIPT K71804008M, e perfaqesuar nga Aministratori, Z.Pandeli Garo madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit ID me numer personal G41006076B.

Ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 „Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare „, si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit “ themeloj me vullnet te lire shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar ,me emertim **Protonclub** .

NENI 2  
SELIA

Selia e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **Protonclub**, me adrese Tirane, Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shkalla A, Kati 10. Shoqeria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin.

NENI 3  
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **Protonclub** eshte pa afat nga momenti i regjistrimit te saj prane QKB Tirane.

NENI 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise **Protonclub** eshte:

- Agjent dhe/ose ndermjetes per rezervimet Hoteleve, restoranteve, paketave turistike gjithëperfshirese per te trete vendas ose te huaj. Aktivitet tregtare ne fushen e turizmit kulturor dhe ne fushen e hotelerise, organizimi i udhetimeve turistike, biznes-ture, pushime, sherbime per udhetime tokesore, ajrore e detare. Rezervime dhe pergatitje biletash. Sherbime dhe prenotime hotelesh brenda dhe jashte vendit. Sherbimi i organizimit te tureve me guida, toure pa guida, prenotime aktivitetesh te ndryshme per turista, prenotime makina me qera per klientet.
- Organizimit e formave te udhetimeve turistike, udhetime pune, etj, shitje / blerje te paketave turistike, Udhetime Turistike me grupe te organizuara brenda dhe jashte vendit, Organizim turesh brenda dhe jashte vendit. Pushime dhe udhetime me krociera. Shoqeria bashkepunon me agjenci te tjera turistike, udhetimi, shoqeri transportesh etj., vendase dhe/ose te huaja, hotele, resorte, restorante.

Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 5  
KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë **Protonclub** është **100,000 leke** dhe i ndare ne 1 kuote me kontributin e ortakut te vetem te shoqerise, si me poshtë:

1. **Shoqeria “Proton”** Sh.p.k, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit e me NIPT K71804008M, e perfaqesuar nga Administratori, **Z.Pandeli Garo** madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit ID me numer personal G41006076B, Shoqeria zoteron 1 kuote ne masën 100 % (njeqind perqind) te kapitalit te Shoqerise.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku themelues , ai mund të ndryshoje sipas vendimit që mund të marri ortaku, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 6  
ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese te shoqërisë **Protonclub** janë:

- Asambleja e Ortakeve, organi me i larte vendimmarres
- Administrator te shoqerise eshte **Z.Pandeli Garo**, me nr personal G41006076B.
- Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet, **nga data 12/12/2024 deri ne 12/12/2029**

NENI 7

Organizimi i shoqerise, marredheniet me persona fizik e juridike, vendas apo te huaj, shprehen ne status qe bashke me aktin themelimit jane dokumentat baze te veprimtarise dhe sherbejne per zhvillimin e marredhenieve ne kete shoqeri.

NENI 8

Veprimtarine e saj, shoqeria do te zhvilloje ne perputhje me legjislacioni Shqiptar.

NENI 9

Te gjitha mosmarreveshjet me persona fizike ose juridik si dhe me organet shtetore zgjidhen me mirekuptim, me ane te dispozitave te ketij akti, statuti si dhe legjislacioni shqiptar dhe kur keto mjete nuk japin rezultat atehere zgjidhen me gjykate.

Ky akt themelimi hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **Protonclub** ne QKB ne kete dite shoqeria **Protonclub** njihet si person juridik.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE “Protonclub”**

**Shoqeria “Proton” shpk**  
*Perfaqesuar nga Administratori*  
**Z.Pandeli Garo**



*Z. Pandeli Garo*  
**PANDELI**